



In medias res


Formulimi i Vizionit (2)

Në kohë të ndryshimesh të mëdha, shoqëria u drejtohet shkollave të saj për t'i ndihmuar qytetarët t'u përshtatet këtyre ndryshimeve. Jo rrallë, shoqëria kërkon që shkollat t'i modifikojnë programet e tyre, me qëllim që nxënësit të jenë të aftë të funksionojnë në mënyrë më të efektshme në kohë të sotme. Pak arsimtarë do të guxonin t'u përgjigjeshin kërkesave të shumta ndaj shkollave, pa përmendur deri diku edhe qëllimet arsimore. Po shpesh ata nuk janë të përpiktë në përdorimin e gjuhës arsimore. Jo rrallë, termi 'qëllime' përdoret në mënyrë të ndërsjellë me termat synime, përfundime, funksione, objektiva të përgjithshëm dhe pikësnyime"

Allan.C Orstein & Francis P. Hunkins

Në përfundim të shqyrtimit të konceptit vizion, duhet ta bëjmë këtë digresion për të mënjeluar dilemat e ndryshme konceptuale që lidhen me shpjegimet e mëtejme të operacionalizimit dhe të konkretizimit të vizionit, përkatësisht të shndërrimit të ëndrrës së madhe në zhgëndërr të madhe. Vizioni në gjuhën angleze jo rrallë përcaktohet si ëndërr (dream). Kështu ndër të tjerat thuhet se qëllimi i shkollave në Amerikë është: "...që ëndrrat e amerikanëve t'i bëjnë realitet".

Për këtë arsye edhe në literaturë ndonjëherë ngatërrohet koncepti i vizionit me qëllimin. Kështu autorët amerikanë: Allan C. Orstein nga Universiteti i Lojola në Çikago dhe Francis P. Hunkins nga Universiteti i Uashingtonit citojnë M. Fullanin dhe A. Pmfret, të cilët deklarojnë se "Qëllimet janë formulime të përgjithshme. Ato u japin formë dhe drejtim veprimeve më të përgjithshme që kanë për synim të realizojnë një produkt, ose një sjellje të caktuar në të ardhmen. Qëllimet janë pikënisja që sugjeron një ideal dhe një vizion frymëzues të së mirës". Si shihet këtu vizion dhe qëllim sikur unifikohen në kuptimin semantik trajtohen si synime. Në gjuhën shqipe vizioni më shumë përputhet me synim, ndërsa qëllimi më shumë përputhet me objektivat e përgjithshme, ndërsa objektivat specifike janë konkretizime që përcaktohen për njësitë mësimore. Vizion buron nga filozofia kurrikulare, qëllimet- objektivat e përgjithshme burojnë nga vizioni, objektivat specifike-pikësnyimet apo rezultate e pritshme burojnë nga objektivat e përgjithshme Ky konkretizim paraqitet në Skemën 1.



Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Më 10-11 maj 2011 është mbajtur trajnimi për hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës (PZSH) për përfaqësuesit e shkollave serbe të Gracanicës dhe të Shtërpçës. Përveç përfaqësuesve të shkollave në trajnim kanë marr pjesë dhe zyrtarë të DKA-ve dhe përfaqësues të MASHT. Trajnimi është mbajtur sipas agjendës së paraparë. Më 16 maj 2011 është mbajtur dita e tretë e trajnimit për PZSH për përfaqësuesit e 57 shkollave të ciklit të dytë të cilat do të përkrahen nga programi i GZSH. Në këtë ditë është bërë paraqitja e drafteve të PZSH të shkollave përfituese dhe janë marrë instruksione për finalizimin e tyre. Meqenëse në këtë rund janë vetëm 3 shkolla serbe, atëherë ndihma për finalizimin e PZSH është realizuar përmes ofrimit të ndihmës në shkolla.

■ Në periudhën 23-31 maj janë mbajtur trajnimet për hartimin e projekt propozimeve për përfaqësuesit e shkollave në ciklit të dytë. Për shkak të numrit të vogël të shkollave për rajon, trajnimet janë mbajtur në 5 qendra: në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë dhe Ferizaj. Përfaqësuesit e shkollave të rajonit të Pejës kanë vijuar trajnimin në Gjakovë, ndërsa ato të rajonit të Gjilanit e kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në Ferizaj. Për përfaqësuesit e shkollave serbe është mbajtur trajnimi në Gjuhën Serbe në Prishtinë. Në këtë trajnim morën pjesë vetëm dy nga tri shkollat serbe të ciklit të dytë.

■ Gjatë muajit maj, bashkëpunëtorët profesional të terrenit (BPT) kanë ndihmuar shkollat jashtëzakonisht shumë në kompletimin e dokumenteve dhe procedurave të nevojshme për prokurim.

Numri i madh i shkollave në rundin e parë, neglizhenca e një numri të konsiderueshëm të përfaqësuesve të shkollës për të lexuar doracakun e prokurimit dhe për të përcjellë me kujdes procedurat e prokurimit është duke sjellë vonesa në realizimin me kohë të projekteve të këtyre shkollave. Po ashtu, kanë filluar dhe monitorimin e jashtëm të realizimin të projekteve dhe kanë raportuar me kohë për gjetjet nga monitorimi.

KOSOVISION Contest

■ Këtë muaj kanë përfunduar me projektet e tyre klasat fituese të projektit. Projektet kanë qenë nga më të ndryshmet si kopshte shkollore, kopshte botanike, botim i librave apo revistave, biblioteka dhe shumë projekte tjera interesante. Gjatë tërë muajit janë bërë vizita të shumta në terren me ç'rast janë vizituar pothuajse të gjitha projektet shkollore. Po ashtu gjatë këtij muaji, mësime të ndryshme dhe nxënësit e klasave fituese kanë bërë përgatitjen e dokumentimit të projektit të cilin dokumentim e kanë dorëzuar tek menaxhuesit e projektit për të bërë edhe përzgjedhjen e raundit të dytë të fituesve të KOSOVISION CONTEST III. Këtë muaj është filluar edhe me organizimin e ceremonisë finale e cila do të mbahet në muajin qershor të vitit 2011 ku si çdo herë tjetër, të ftuar do të jenë 400-600 persona.





Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

- Është punuar në raportin e dytë të monitorimit pas mbledhjes së të dhënave nga monitorimi i katërt. Raporti është dërguar në përkthim edhe për gjuhë serbe dhe angleze dhe muajin qershor planifikohet edhe botimi i këtij raporti. Pas përfundimit të botimit të raportit, fillojmë me përgatitjet e diskutimit publik.

Grantet shkollore kanë përfunduar me projektet e tyre në të gjitha shkollat ashtu si ishte e planifikuar. Të gjitha shkollat kanë bërë edhe raportin për implementimin e projekteve dhe kanë organizuar një ceremoni të vogël në shkollat e tyre pas përfundimit të projekteve shkollore.

Parandalimi i dhunës në shkolla

■ Gjatë këtij muaji ekipi i projektit ka zhvilluar vizita të shumta në terren. Qëllimi i këtyre vizitave është për të shikuar nga afër gjendjen e sigurisë në shkollat tona.

Pas vizitave ekipi i projektit është duke i shkruar raportet e monitorimit. Për secilën shkollë të vizituar, do të shkruhet një raport për gjendjen e pasqyruar me fotografi, dhe pastaj do të shkruhen rekomandimet apo hapat që duhet ndërmarrë nga udhëheqësit e shkollës dhe ata të DKA-së përkatëse.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Përkrahja e Projektit EU Education SWAp që i ofrohet MASHT-it i kushton prioritet ndërtimit të kapaciteteve për zhvillimin dhe menaxhimin e një qasje strategjike në sektorin arsimor. Projekti ka ndihmuar MASHT-in në zhvillimin e planit të parë implementues vjetor për vitin 2011, në linjë me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë, (PSAK 2011-2016). Projekti gjithashtu është duke përkrahur MASHT-in në zhvillimin e një instrumenti për planifikim financiar i cili do të lehtësojë planifikimin financiar bazuar në skenarë të ndryshëm.

■ Më 25-27 Prill projekti ndihmoi MASHT-in në mbajtjen e Punëtorisë së parë për Planifikimin e Buxhetit Vjetor, ku u zhvillua një draft plan buxhetor për MASHT-in, institucionet e arsimit të lartë, komunat dhe institucione tjera arsimore për vitin 2012. Kjo do të ofrojë informacione për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të qeverisë (KASH). Pritet që në të ardhmen Punëtorja për Planifikimin e Buxhetit Vjetor do të bëhet element esencial për planifikim vjetor dhe ciklin buxhetor, me kohë për t'u qenë në linjë me kërkesat e Ministrisë së Financave për informacione buxhetore.

■ Projekti vazhdon ta përkrahë MASHT-in në zhvillimin e kurrikulimit dhe është arritur shumë progres në finalizimin e Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës, rishikimin e Rezultateve Mësimore Thelbësore për secilën nga gjashtë fushat mësimore, dhe në zhvillimin e Rezultateve Mësimore për Nivele dhe Shkallë të cilat do të udhëheqin procesin e promovimit të nxënësve deri në fund të secilit vit mësimor. Projekti ndihmoi MASHT-in në zhvillimin e Udhëzuesve për Mësimdhënës dhe Udhëzuesve për Drejtorë të Shkollave për të mbështetur mësimdhënësit dhe shkollat në modernizimin e praktikës së mësimdhënësve dhe për të plotësuar Standardet Arsimore në nivel të Bashkimit Evropian.

■ Projekti gjithashtu përkrahu MASHT-in në fushën e zhvillimit të mësimdhënësve duke zhvilluar standardet e kompetencave të mësimdhënësve ku listohen të gjitha fushat që lidhen me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet të cilat duhet të posedohen nga secili mësimdhënës i ri për të fituar licencën e mësimdhënësit. Projekti është duke ndihmuar Këshillin Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve në identifikimin e mundësive të trajnimeve për zhvillim

profesional të mësimdhënësve që kërkohen nga mësimdhënësit. Pos kësaj, projekti përkrahu Zyrën e Rektorit dhe Dekanin e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës në zhvillimin e seminareve në lidhje me zhvillimet aktuale në fushën e edukimit që ligjërohen nga anëtarët e Fakultetit të Edukimit. Gjithashtu, Projekti ndihmoi MASHT-in dhe Zyrën e Rektorit të Universitetit të Prishtinës në hartimin e një deklaratë të përbashkët për strukturën e ardhshme të Fakultetit të Edukimit.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Gjatë kësaj periudhe, në të gjitha QM-të janë identifikuar maturantët që pritet të përfundojnë shkollën e mesme të lartë dhe të cilët duhet t'i nënshtrohen Testit të Maturës. Për këta maturantë janë organizuar Kurse Përgatitore disaditore, të cilat kanë pasur për qëllim që t'i përgatisin nxënësit që sa më me sukses të përfundojnë Testin e Maturës.

■ Po ashtu, gjatë muajit maj për të gjashtë QM-të janë kontraktuar pesë kompani, të cilat do të bëjnë furnizimin e QM-ve me gjysmë-shujtë në baza ditore dhe të gjithë fëmijët dhe nxënësit e Programit Parashkollor dhe Programit për Detyrat e Shtëpisë që vijnë këto programe në QM, do të ushqehen me një gjysmë-shujtë për çdo ditë pune.

Gjatë këtij muaji, KEC ka realizuar mjaft vizita monitoruese nëpër QM dhe mund të thuhet se të gjashtë Qendrat Mësimore (QM) që funksionojnë në kuadër të Projektit EU SIMRAES kanë imlementuar dhe janë duke implementuar programet e parapara me projekt.

Përgatiti: Petrit Tahiri